

K O N T R A T E
A K T - T H E M E L I M I
U N I O N S I G U R A C I O N E
(S H P K)

Sot me date 11/03/2000 ne Tirane i nenshkruari :

Piro Ikonomi, i biri i Naunit, lindur ne Fier, me 16/04/1959, banues ne Tirane, rruga Nikolla Lena, p.126, Sh.2, Ap.29, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I leternjoftimit n. EV 426205
Duke pasur te gjitha kompetencat e nevojshme ligjore te deleguara me vendimin e asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "UNIONI FINANCIAR I TIRANES" shpk bashkengjitur keti akti, vendosime vullnetin e tij te lire per sa me poshte vijon:

- Neni 1** Te themeloje nje shoqeri tregtare te tipit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.
- Neni 2** Jetegjatesia e shoqerise eshte e pacaktuar.
- Neni 3** Emertimi i shoqerise do te jete UNION SIGURACIONE sh.p.k. dhe selia e shoqerise do te jete ne adresen Mine Peza, n.2, Tirane.
- Neni 4** Shoqeria do te kete per objekt:
- aktivitetin e konsulences ne fushen e biznesit dhe administrimit
- aktivitetin e agjentit komisionar apo perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.
- dhe ne pergjithesi, te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.
- Neni 5** Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga:

1 - Kontributet ne para

Ato sillen ne para dhe depozitohen konform ligjit ne nje llogari te hapur ne emer te Shoqerise ne formim, ne Banken Kursimeve Tirane, siç rezulton edhe nga certifikata e leshuar nga banka e mesiperme, nga:


NR	Emri i ortakut	Kontributi ne USD
1	UNIONI FINANCIAR I TIRANES shpk	20.000

TOTALI

20.000

Ne total shuma e kapitalit para eshte 20.000 USD.

2 - Kontributi ne natyre



Asnje prej ortakeve nuk sjell kontribute ne natyre.

3 - Totali i kontributeve:

Kontributet ne para arrijne ne 20.000 USD
Kontributet ne natyre arrijne ne ---
Totali i kontributeve arrin ne 20.000 USD

Neni 6 Kapitali themeltar i fiksuar ne 20.000 USD ndahet ne 400 pjese te barabarta me vlefte prej 50 USD secila. Ato ndahen midis ortakeve si vijon:

NR	Emri	Shuma	Pjeset e kapitalit %	Numri rendor
1	UFT shpk	USD 20.000	100	1-400

Sa me lart lexuar dhe pranuar nga administratori me nenshkrimin e tij te lire.
Perpiluar ne pese kopjo me te njejten vlere ligjore.

PIRO IKONOMI

Piro Ikonomi

[Signature]

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "UNION SIGURACIONE"

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", ndryshuar me akte te mevonshme, (ketu e me poshte vetem "Ligji") dhe ne kontraten e themelimit te dates 11/03/2000,

i neshkruari i meposhtem:

UNIONI FINANCIAR I TIRANES shpk, perfaqesuar nga Z. Piro Ikononi, I biri I Naunit, lindur ne Fier, me 16/04/1959, banues ne Tirane, rruga "Nikolla Lena, P.126, Sh.2, Ap.29, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I latornjofimit n. EV 426205

me date 11/03/2000, ne Tirane, vendosi te themeloje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "UNION SIGURACIONE" dhe te jape pelqimin e vet per statutin e saj si me poshte:

Neni 1 – FORMA

Ndermjet zoteruesve te pjeseve te kapitalit themeltar si me poshte dhe atyre pjeseve qe mund te krijohen ne te ardhmen themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar.

Veprimtaria e kesaj shoqerie zhvillohet ne perputhje me kete statut.

Neni 2 – OBJEKTI


Shoqeria ka per objekt kryerjen e aktiviteteve te meposhtme:

- aktivitetin e konsulences ne fushen e biznesit dhe administrimit
- aktivitetin agentit komisionar apo perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.
- dhe ne pergjithesi, te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 3 – EMERTIMI

Emertimi i shoqerise eshte "Union Siguracione" sh.p.k.

Neni 4 – SELIA





Selia e shoqerise do te jete ne adresen Mine Peza, Nr. 2, Tirane, Shqiperi.

Selia mund te zhvendoset brenda rrethit me nje vendim te thjeshte te Administratorit, pasi te jete marre pelqimi i Asamblese se Pergjithshme te Zakonshme dhe ne cdo vend tjeter me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme.

Neni 5 – KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe pa afat.

Neni 6 – KAPITALI THEMELTAR DHE KONTRIBUTET E ORTAKEVE

Vlera e kapitalit themeltar te shoqerise eshte 20.000 (njezetemije) USD.

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga:

1. Kontributet ne para me vlere 20.000 USD.

Keto kontribute nenshkruhen plotesisht nga ortaket dhe depozitohen ne nje Banke qe vepron ne territorin e Republikes se Shqiperise sipas listes se meposhtme.

Neni 7 – PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar ndahet ne 400 pjese te barabarta te tij me vlere 50 USD secila, te nenshkruara dhe paguar teresisht. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme.

Pjeset e kapitalit themeltar ndahen ndermjet ortakëve si me poshte:

Emri i ortakut UNIONI FINANCIAR I TIRANES shpk


Vlera e pjeses se kapitalit themeltar 20.000 USD

Pjesa e kapitali ne % 100%.

Neni 8 – NDRYSHIMET E KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar mund te zmadhohet si duke krijuar pjese te reja, ashtu dhe duke rritur vleren nominale te pjeseve te nenshkruara te kapitalit themeltar. Keto ndryshime mund te behen vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme. Terheqja e fondeve qe vijne nga nenshkrimet ne rast te kontributeve ne para, behet nga nje mandatmbajtes i caktuar nga shoqeria ne menyrene caktuar me siper, pasi te jete plotesuar certifikata e depozituesit.

Kapitali themeltar mund te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.



Ne cdo rast zvogelimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar duhet te rezultojne ne zoterim te pjeseve te plota te kapitalit themeltar nga ana e ortakeve.

Neni 9 – BASHKIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR NE NJE DORE TE VETME

Bashkimi i pjeseve te kapitalit themeltar ne nje dore te vetme nuk con ne prishjen e shoqerise, e cila mund te vazhdoje ekzistencen e saj edhe me nje ortak te vetem.

Neni 10 – TE DREJTAT DHE DETYRIMET E LIDHURA ME PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron ne te gjitha rastet e votimeve dhe vendimeve.

Cdo pjese e kapitalit themeltar i jep zoteruesit te saj te drejten e e pjesemarrjes ne fitimin qe shperndahet, proporcionalisht me vleren e kapitalit themeltar. Kjo vlen dhe per pjesen e mbetur te kapitalit te shoqerise qe i shperndahet ortakeve pas likuidimit te saj.

Neni 11 – PANDASHMERIA E PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR


Pjeset e kapitalit themeltar jane te pandashme. Bashkezoteruesit e pjeses se kapitalit themeltar jane te detyruar te zgjedhin njerin prej tyre per t'i perfaqesuar ata ne marredheniet me shoqerine. Ne rast mosmarreshjeje mes tyre, perfaqesuesin e bashkezoteruesve e cakton gjykata me kerkese te cdonjerit prej tyre.

Neni 12 – TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar vertetohen me nje akt noterial.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve dhe bashkeshorteve, paraardhesve apo pasardhesve te ortakeve edhe kur keta nuk jane ortake. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar ne rruge trashegimie apo ndarjeje pasurore ndermjet bashkeshorteve behet vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne minimumi tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar, duke perjashtuar trashegimtarete ne rast transmetimi per shkak vdekjeje, apo bashkeshortet ne rast ndarjeje pasurore ndermjet bashkeshorteve. Paragrafi i meposhtem zbatohet edhe per



rastet kur refuzohet miratimi i ortakut te ri. Nese asnje nga zgjidhjet e parashikuara ne kete paragraf nuk arrihet ne afatet e parashikuar nga ky statut, miratimi konsiderohet i dhene.

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme tek personat e trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, pervec rrethit te personave te percaktuar ne paragrafin e mesiperm, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve nepermjet nje shkrese te vertetuar me akt noterial. Brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga ky njoftim, administratori duhet te mbledhe Asamblene e Pergjithshme te Zakonshme per te vendosur mbi projektin e transferimit te pjeseve te keapitalit themeltar. Vendimi i kesaj Asambleje i behet i ditur ortakut qe do te transferoje pjeset e tij me dergese postare te regjistruar. Ne qofte se shoqeria nuk e ben te ditur vendimin e saj brenda nje periudhe tremujore nga njoftimi i fundit i parashikuar ne kete paragraf, pelqimi i shoqerise per kete transferim konsiderohet i dhene. Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar sipas nenit 11 te Ligjit. Brenda ketij afati, shoqeria mund te bleje pjeset ne rast se Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme merr vendim per zvogelim te kapitalit themeltar me vleren nominale te pjeseve te leshuesit, zvogelim ky qe nuk motivohet nga humbjet, dhe anulon pjeset e blera si pjese te kapitalit themeltar ne sipas paragrafit te peste te nenit 64 te Ligjit.

Neni 12/1- VDEKJA, FALIMENTIMI OSE PAAFTESIA E NJE ORTAKU


Shoqeria nuk priset kur vdes, falimenton ose shfaq paaftesi nje prej ortakeve.

Neni 13 – ADMINISTRIMI

Shoqeria administrohet nga nje a me shume persona fizike, ortake ose jo, te zgjedhur nga ortaket qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit.

Z. PIRO IKONOMI emerohet Administrator i pare i shoqerise per nje periudhe pa afat. Paga e tij do te caktohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Zakonshme ne mbledhjen e pare te saj. Atij i lind e drejta te qe shoqeria te mbuloje apo ta paguaje per shpenzimet qe lindin nga kryerja e veprimtarise se Administratorit.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredheniet me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe Ligji ua jep shprehimisht ortakeve. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratoreve edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta



injononin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 14 – EKSPERTET KONTABEL

Ortaket me shumice te zakonshme votash caktojne nje apo me shume eksperte kontabel. Honoraret e tyre perballohen nga shoqeria sipas vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Zakonshme.

Neni 15 – MARREVESHJET NDERMJET SHOQERISE DHE NJE PREJ ADMINISTRATOREVE OSE ORTAKEVE TE SAJ

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje prej administratoreve ose ortakeve jane te vlefshme vetem nese miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme. Ortaku i interesuar nuk merr pjese ne votim dhe pjeset e tij te kapitalit themeltar nuk merren parasysh ne llogaritjen e quorumit dhe te shumices. Kjo Asamble vendos ne baze te raportit te pergatitur nga Administratori apo eksperti kontabel i autorizuar, raport qe duhet te permbaje:

- radhen e marreveshjeve qe kane nevoje per miratim;
- emrin e Administratorit apo ortakut te interesuar ne marreveshje;
- natyren dhe objektin e marreveshjes;
- elementet thelbësore te marreveshjes, vecanerisht cmimet apo tarifat, te ardhurat komisionet, afatet e pagesave, interesat e zbatuara, sigurite e dhena, dhe cdo element tjeter qe u jep mundesine ortakeve te gjykojne objektivisht interesin qe lidhet me kete marreveshje;
- pasojat e lidhjes se nje marreveshjeje te tille per shoqerine.

Neni 16 – VENDIMET


Ne rast te disa ortakeve vendimet merren ne keto forma:

1. Nepermjet konsultimit me shkrim te ortakeve, nese te gjithë ortaket miratojne me shkrim permbajtjene e konsultimit;
2. Ne mbledhjet e Asamblese te Pergjithshme te Zakonshme dhe ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme.

Ortaket mund te perfaqesohen nga nje person tjeter.

Ortaket thirren ne Asamble nga Administratori i shoqerise, ose nga nje person i ngarkuar me kete detyre nga gjykata me kerkese te ortakeve.

Asamblete e ortakeve mblidhen ne seli ose ne cdo vend tjeter te shenuar ne thirrje. Ato drejtohen nga Administratori, dhe kur ai nuk eshte ortak, nga ortaku i pranishem qe perfaqeson numrin me te madh te pjeseve te kapitalit themeltar. Kur dy



ortake zoterojne ose perfaqesojne te njejtin numer te pjeseve, dhe pranojne drejtimin e Asamblese, ai realizohet nga me i moshuari.

Cdo vendim i Asambleve te ortakeve regjistrohet ne proces verbal, i cili hartohet dhe nenshkruhet nga drejtuesi si dhe nga ortaket e pranishem. Proces verbalet hartohen dhe mbahen ne nje regjister me flete te numeruara ose me flete te shkeputura gjithashtu te numeruara ne perputhje me kushtet e rregullores. Kopjet e proces verbaleve vertetohen te jene ne perputhje me origjinalin nga Administratori.

Neni 17 – VENDIMET E ZAKONSHME

Ne Asamblene e Pergjithshme te Zakonshme merren vendime kolektive te zakonshme, qe jane ato vendime qe nuk kane lidhje me ndryshime ne statut apo marreveshjet per transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar, te drejtes se anetaresimit.

Brenda gjashte muajve nga mbyllja e aktivitetit, ortaket mblidhen ne Asamblene e Pergjithshme te Zakonshme per te marre vendim per llogarite e aktivitetit dhe per shperndarjen e fitimit.

Vendimete zakonshme merren nga nje a me shume ortake qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit. Nese kjo shumice nuk arrihet, vendimet merren per here te dyte me shumicen e votave te dhena, ciido qofte numri i votuesve.

Merren gjithmone me shumice absolute te pjeseve te kapitalit themeltar vendimet per emerimin apo shkarkimin e Administratorit.


Vendimet e zakonshme mund te merren edhe me konsultimme shkrim te ortakeve nese kjo nuk bie ndesh me dispozitat e Ligjit ose te ketij statuti.

Neni 18 – VENDIMET E JASHTEZAKONSHME

Quhen te jashtzakonshme vendimet qe kane per objekt modifikimin e statutit apo qe kane te bejne me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar dhe te drejten e anetaresimit.

Vendimet e jashtzakonshme merren ne Asamblene e Pergjithshme te Jashtzakonshme dhe konsiderohen te vlefshme kur:

- jane marre unanimisht ne rast te transferimi te shoqerise jashte territorit te Republikes se Shqiperise, rritjes se pjesemarrjes se nje ortaku ne shoqeri, apo shnderrimit te saj ne formen e shoqerise komandite apo shoqerise kolektive;
- jane marre me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit, ne rastin e pranimi te ortakeve te rinj dhe ne cdo rast tjetër te marjes se vendimeve te jashtzakonshme.





Neni 18 – E DREJTA E ORTAKEVE PER T'U INFORMUAR

Cdo ortak ka te drejten qe ne cdo kohe te informohet ne cdo kohe per veprimtarine e shoqerise dhe te njihen me llogarite dhe dokumentet e shoqerise.

Cdo ortak ka te drejte qe t'i vihet ne dispozicion dokumentacioni apo kopje te tij qe shoqeria disponon.

Neni 19 – VEPRIMTARIA FINANCIARE E SHOQERISE

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te po atij viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne ditën e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe mbaron me 31 Dhjetor 2000.

Ne mbylljen e cdo aktiviteti vjetor, Administratori harton nje bilanc te aktivitetit dhe pasivit te shoqerise, llogarite humbje fitim dhe nje raport te veprimtarise vjetore ku pershkruhen rezultatet, ecuria, veshtiresite e hasura parashikimet per kapercimin e tyre, planet e zhvilimit per te ardhmen. Te gjitha keto vihen ne dispozicion te ekspertit kontabel te pakten nje muaj dhe ne dispozicion te ortakëve te pakten 15 (pesembedhete) dite perpara thirrjes se Amblesë qe do te shqyrtoje rezultatet financiare vjetore.

Neni 20 – PERCAKTIMI DHE SHPERNDARJA E FITIMIT

Fitimi qe do te shperndahej perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit dhe nga na tjetër jane zbritur apo shuar respektivisht humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e meparshme.


Ky fitim shperndahej midis te gjithë ortakëve proporcionalisht me numrin e pjeseve te kapitalit themeltar qe i perkasin secilit prej tyre. Kjo shperndarje duhet realizuar brenda 9 (nente) muajve pas mbylljes se aktivitetit.

Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme mund te vendose kalimin e shumes se fitimit qe mund te shperndahej ne rikapitalizimi, pjeserisht apo teresisht.

Neni 21 – SHDERRIMI I SHOQERISE

Shnderrimi i shoqerise ne shoqeri komandite apo shoqeri kolektive behet me pelqimin unanimit te te gjithë ortakëve.

Shnderrimi i shoqerise ne shoqeri anonime behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Jashtzakonshme ne perputhje me kerkesat e neneve 73 dhe 77 te Ligjit.



Ne kuptim te ketij neni eksperti kontabel i autorizuar mund te sherbeje edhe si ekspert per transformimin, ne qofte caktohet si tille nga ortaket, apo ne rast mosmarreveshjeje mes tyre nga gjykata.

Neni 22 – PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Shoqeria prishet ne rast se objekti i saj shuhet, apo kur ka nje vendim te gjykates.

Prishja e shoqerise para afatit mund te vendoset nga ortaket qe perfaqesojne tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar.

Shoqeria eshte ne likuidim e siper nga momenti prishjes se saj per cdolloj aresye.

Ndarja e kapitaleve te veta, qe mbeten pas pagimit te shumes nominale te pjeseve te kapitalit themeltar, behet ndermjet ortakeve ne perpjesetim me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 23 – REGJISTRIMI

Shoqeria eshte person juridik qe nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregtar.

Perpara nenshkrimt te statutit jane kryer per llogari te shoqerise ne formim e siper veprimet e percaktuara ne Aneksin A te ketij statuti qe behet pjese e tij me nenshkrimin e tij.

I jepet fuqi e plote Z.Edmond Leka per kryerjen e te gjitha veprimeve te publikimit dhe regjistrimit lidhur me formimin e shoqerise dhe mbi te gjitha:

- Per kryerjen e te gjitha veprimeve te nevojshme per regjistrimin e shoqerise ne regjistrin tregtar;
- Per mbajtjene e nje origjinali apo kopje te statutit te nevojshem per kryerjen e ketyre veprimeve.

*Sa me lart, lexuar dhe pranuar nga administratorti I shoqerise me nenshkrimin e tij:
Perpiluar ne pese kopjo me te njejten vlere ligjore.*

PIRO IKONOMI

